



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

VENDIM

Nr 17 Datë 30/12/2015

PËR SHKRIRJEN E NDËRMARRJEVE TË RRUGËVE RURALE NË VARËSI TË  
KËSHILLIT TË QARKUT VLORË

Këshilli i Qarkut Vlorë, në mbledhjen e datës së mësipërme, në mbeshtetje të ligjit Nr. 8652, date 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e organeve të Qeverisjes Vendore", neni 13 pika 1, neni 54, VKM nr. 915 dt. 11.11.2015 "Për kalimin në pronësi nga Këshillat e Qarqeve të Bashkitë, të rjetit të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve, Udhëzuesit për zbatimin e VKM 915 dt 11.11.2015 me nr 500/2 prot dt 07.12.2015 pika 2, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30 dt. 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njesitë, e sektorit publik" i ndryshuar, me kërkesë të Kryetarit të Këshillit të Qarkut:

VENDOSI

- 1) Të miratojë shkrirjen e Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Rrugëve Vlorë dhe Ndërmarrjen e Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Rrugëve Sarandë – Delvinë.
- 2) Të nisin procedurat për transferimin në pronësi, nga ndërmarrjet e mirëmbajtjes së rrugëve rurale nëpër bashkitë përkatëse të:
  - a) Aseteve të paluajtshme të këtyre ndërmarrjeve të bashkitë në territorin e të cilave është vendndodhja e tyre sipas tabelës 2 bashkëlidhur VKM 915 dt. 11.11.2015
  - b) Mjeteve motorrike sipas tabelës 3 bashkëlidhur VKM 915 dt. 11.11.2015
  - c) Mjeteve e pajisjeve të këtyre ndërmarrjeve
- 3) Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut ose personi i autorizuar prej tij.
- 4) Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 8652 date 31.07.2000 neni 55 pika 3.

Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë  
  
Sadrit Danaj

Shpallur me dt. / / me nr. nga Prefekti i Qarkut Vlorë

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë  
Sheshi "4 Heronjtë", Vlorë  
Vlorë (AL)

Web site: [www.qarkuvlore.gov.al](http://www.qarkuvlore.gov.al)  
E-mail: [info@qarkuvlore.gov.al](mailto:info@qarkuvlore.gov.al)  
Tel: +355 33 421 600